



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 947/8 prot**

**Datë 02.07.2021**

**V E N D I M**  
**Nr. 333/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit Nr. REF-96147-05-21-2021 me objekt “*Dezinfektim, dezinfektim, deratizim ambientesh*”, me fond limit 1,311,960 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
- Ankimues:** Operatorit ekonomik “Gurali Stafaj” pf  
*Adresa: Rruga “Jordan Misja”, godina nr.3, Tiranë*
- Autoriteti kontraktor:** Agjencia e Mbrojtjes se Konsumatorit.  
*Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. II.1. Në datën 24. 05.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit, me Nr. REF-96147-05-21-2021 me objekt “Dezinfektim, dezinfektim, deratizim ambientesh”, me fond limit 1,311,960 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2. Në datën 31.05.2021 operatori ekonomik “Gurali Stafaj” pf ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 947/3 prot datë 04.06.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Gurali Stafaj” pf.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.756/3 prot., datë 08.06.2021 , protokolluar me tonën me nr. 947/4 prot., datë 08.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Gurali Stafaj” pf. dhe me shkresën nr. 772 prot., datë 02.06.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës në lidhje me shtojcën 8 për pajisjen Granulator dore.

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se kjo pikë e ankesës është pranuar pjesërisht si vijon: [...]Lidhur me granulatorin e dorës është menduar për vendet e thella, mbropa rafteve ku nuk mundtë futet dora, por është një pajisje jo e domosdoshme e cila nuk do ju kërkohet operatorëve ekonomikë për zhvillimin e kësaj procedure. Po të shikohet dhe pika 2.3.6. kjo pajisje nuk është kërkuar fare në mostrat që do të sillen.

*Si përfundim Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës konstaton se:*

*Kriteret e kërkua në Dokumentet Standarde të Tenderit, janë në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014, për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*Për sa parashtruar më sipër, rekomandojmë:*

*1. Heqje e pajisjes granulator dore nga rodenticidet dhe mbajtjen e kriterëve të tjera të kualifikimit të pandryshuar[...]*

II.7 Ndërmjet shkresës nr. 947/5 date 16.06.2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka ridërguar shkresë për informacion në lidhje me specifikimin teknik Granulator dore, pasi në informacionin e depozituar pranë KPP-së kthim-përgjigja e autoritetit kontraktor në lidhje me këtë specifikim ishte konfuze.

II.8 Nëpërmjet shkresës nr.947/5 prot., datë 17.06.2021 , protokolluar me tonën me nr. 947/6 prot., datë 21.06.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kthim-përgjigja e autoritetit kontraktor në lidhje me specifikimin teknik Granulator dore ku sqaron se;

*Nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nëpërmjet rekomandimeve me Nr.772 Prot., datë 02.06.2021 si dhe në kthimin e përgjigjes për ankesën me Nr.756/1 Prot., datë 02.06.2021 drejtuar operatorit ekonomik dhe KPP-së, janë sqaruar me detaje të gjitha pretendimet e ngritura dhe është dalë në konkluzionin se:*

*-ankesa është pranuar vetëm për pjesën e heqjes së pajisjes granulator dore nga rodenticidet;*

*- pretendimet e tjera të ngritura nuk janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës;*

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Gurali Stafaj” pf për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Së pari tek Kriteret e veçanta, në pikën 2.3.3, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, si më poshtë:

- *Praninë e një punonjësi përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren, nuk është e nevojshme pasi pajisjet që do të përdoren janë të kalibruara dhe nuk kanë nevojë për ekspert përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin.*

- *Prania e dy teknikëve shërbimi për DDD, është e panevojshme pasi kjo detyrë kryhet nga drejtuesi teknik i profilit (inxhinier kimist, biolog etj), i cili u jep instruksionet aplikuesve të lëndëve të DDD.*

*Ne si Operator Ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, e gjujkojmë të panevojshme praninë e një punonjësi përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve dhe praninë e dy teknikëve të shërbimit për DDD.*

*Kjo për arsye se, referuar preventivit të sipërfaqeve ku duhet të kryhen shërbimet, frekuencën e kryerjes së shërbimit etj., kjo është një kërkesë e ekzagjeruar. Kalibrimi i pajisjeve bëhet përpara fillimit të shërbimit dhe nuk duhet të bëhet sa herë që kryhet ai shërbim. Në eksperiencën tonë disavjeçare, përpara fillimit të shërbimit, kalibrimi i pajisjeve është i detyrueshëm. Kjo bëhet në prezencë të drejtuesit teknik dhe të personave përgjegjës nga ana e autoritetit kontraktor, në përputhje me udhëzimet e pajisjes përkatëse. Pas kësaj, nuk është e nevojshme që pajisja të kalibrohet çdo herë përpara kryerjes së shërbimit. Kjo gjë, jo vetëm që nuk është e nevojshme, por edhe pengon kryerjen e punës në kohë. Nga ana e autoritetit kontraktor, mund të kërkohet garancia që pajisjet janë të kalibruara, por jo të kërkohen që të jenë të pranishëm punonjës përgjegjës për kalibrimin e pajisjeve. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik dhe profesional”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: **2.3.3** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

- *1 (një) drejtues teknik i profilit (inxhinier kimist, biolog, etj.)*
- *1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë*
- *1 (një) punonjës përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren*
- *2 (dy) teknik shërbimi për DDD*
- *4 (katër) aplikues të lëndëve DDD*

*Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:*

- *Kontratat individuale të punës (afati i vlefshmërisë së kontratave të punës duhet të jetë për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës)*

- *Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore, për periudhën Shkurt 2021 – Prill 2021.*
- *Diplomë ose / dhe certifikata trajnimesh. Këto dokumente duhet të jenë të lëshuara nga institucione të njohura ose akredituara në Republikën e Shqipërisë.*
- *Vërtetim nga Administrata Tatimore ose Dega e Sigurimeve Shoqërore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Shkurt 2021 – Prill 2021.*

-

III.1.2. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar*

*kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se; *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. 6. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.*

III.1.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.7. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se: *1. Në lidhje me pikën 1 ku kërkohet një punonjës përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren operatori ekonomik është shprehur si fillim se nuk ka nevojë për këtë punonjës se pajisjet që do të përdoren janë të kalibruara dhe më poshtë shprehet se "...Kalibrimi i pajisjeve bëhet përpara fillimit të shërbimit dhe nuk duhet të bëhet sa herë që kryhet ai shërbim. Në eksperiencën tonë disavjeçare, përpara fillimit të shërbimit, kalibrimi i pajisjeve është i detyrueshëm. Kjo bëhet në prezencë të drejtuesit teknik dhe të personave përgjegjës nga autoriteti kontraktor, në përputhje me udhëzimet e pajisjes përkatëse. Pas kësaj, nuk është e nevojshme që pajisja të kalibrohet çdo herë përpara kryerjes së shërbimit. Kjo gjë, nuk është e nevojshme por edhe pengon kryerjen e punës në kohe".*

*Pra, siç dhe është cituar nga vetë operatori ekonomik punonjësi përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin nuk kërkohet të jetë prezentë në çdo kryerje shërbimi, por vetëm përpara fillimit të shërbimit, kalibrimi i pajisjeve është i detyrueshëm. Kjo bëhet në prezencë të drejtuesit teknik dhe të personave përgjegjës nga autoriteti kontraktor.*

*Referuar dhe udhëzuesit “Mbi kontrollin e vektorëve dhe brejtësve në Shqipëri” nga Instituti i*

*Shëndetit Publik shprehet qartë se pajisjet duhet të kalibrohen periodikisht për të sprucuar sasinë korrekte të volumit të lëngut/minutë. Konkretisht, për të sprucuar në një gjërësi të caktuar duhet kalibruar pajisja në këndin e dëshiruar të sprucimit si dhe duhet mbajtur pajisja në një largësi të caktuar nga sipërfaqja e sprucimit.*

*Lidhur me praninë e dy teknikë shërbimi për DDD sqarojmë se:*

*Drejtuesi teknik bën planin e punës, përcakton llojin e insekteve të viruseve etj, pra anën teorike të këtij shërbimi. Ndërkohë që tekniku i shërbimit duhet të jetë patjetër në terren (vendet e përcaktuara për kryerjen e shërbimit DDD nga autoriteti kontraktor), për të përgatitur ilaçet për llojin e situatave specifike të studiuara dhe përcaktuara nga drejtuesi teknik. Më pas është aplikuesi i lëndëve DDD që e realizon shërbimin final..*

III.4.4. Në VKM Nr.538 datë m 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” për kategorinë II.8 shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare përcaktohet se: “1. Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjieno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”10[10]

2. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon: a) “shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore” me kodin II.8.A; b) “shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B. c) veprimtari në fushën e shëndetit publik që nuk licencohen sipas një kategorie tjetër me kodin II.8.C

3. Një subjekt, sipas kërkesës së tij mund të licencohet për një apo të dy këto nënkategori sipas shkallës së plotësimit të kriterëve përkatëse të licencimit.

4. Licenca e këtyre veprimtarive është pa afat.

5. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë A, B, C të veprimtarisë jepen në tabelën 1 më poshtë. Tabela 1 Kriteret e posaçme Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme Përshatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit Drejtuesi teknik sipas rasteve specifike a) Certifikatë për drejtuesin teknik. b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës.

6. Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë A, B, C bëhet sipas grupit

II. 7. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.1.8 Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi kërkesën e autoritetit kontraktor (një) person përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren, shërbimi referuar objektit të prokurimit është i ekzagjeruar dhe joproporcional me objektin e prokurimit, pasi kalibrimi i pajisjeve bëhet

periodikisht, kjo sipas Udhëzuesit mbi kontrollin e Vektorëve dhe brejtësve në Shqipëri ku citohet se “*Pompa duhet të kalibrohet periodikisht për të sprucuar sasinë korrekte të volumit të lëngut në minute*” pra në asnjë rast nuk është parashikuar se kalibrimi i pajisjeve bëhet përpara fillimit të shërbimit. Gjithashtu lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi kërkesën e autoritetit kontraktor 2 (dy) teknikë shërbimi referuar objektit të prokurimit është e ekzagjeruar dhe joproporcionale me objektin e prokurimit, pasi kërkesat e mësipërme mund të përmbushen më së miri nga drejtuesi teknik me certifikimin përkatës, kjo sipas VKM-së së sipërcituar. Autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin për punonjës person përgjegjës për kolaudimin dhe kalibrimin e pajisjeve dhe e heq kriterin për punonjës teknik e shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Gurali Stafaj” për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “*[...]dyti, referuar shtojcës 8 të specifikimeve teknike Autoriteti Kontraktor ka bërë përcaktime kontradiktore dhe që bien ndesh me legjislacionin në fuqi, të cilat janë si vijon: Autoriteti kontraktor ka përcaktuar të nevojshëm preparatin e tipit Cypermethrinë 10 gr plus tetramethrin 2 gr, për luftimin e mushkonjave e insekteve zvarritëse dhe fluturuese gjë e cila nuk është e mundur pasi insektet luftohen që në larvë. Dhe në rastet e situatave të jashtëzakonshme ku kemi praninë e insekteve procedohet me leje të posaçme. Nëpërmjet përcaktimit të preparatit për luftimin e mushkonjave, Cypermethrin 10 gr plus tetramethrin 2 gr, dhe preparatit Cypermethrin 100g/l Autoriteti Kontraktor ka bërë përcaktime të panevojshme që pengojnë konkurrencën e hapur, gjithashtu me përcaktimet e detajuara të preparateve favorizohet e një marke specifike gjë e cila bie ndesh me LPP-se. LPP-ja shprehet se nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces I veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet e detajuara në sasi tek preparatet janë një burim specifik që çojnë haptazi në favorizimin dhe eliminimin e disa sipërmarrjeve apo produkteve, pra favorizohet një markë e caktuar. Bazuar në nenin 36 të ligjit Për Prokurimin Publik, Autoriteti kontraktor në përcaktimin e specifikimeve teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, “**Specifikimet teknike**”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon

1. *Preparate për luftimin e mushkonjave dhe insekteve zvarritëse dhe fluturuese. Këto preparate duhet të jenë të tipit Cypermethrin 10 gr plus tetramethrin 2 gr. Aplikimi me pompë profesionale me mjegullues me grimca 5-50 nmic si dhe me mjegulluese elektrostatische.*

III.2.2. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe



*jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

*Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*III.2.4. Neni 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
- ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.
4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.
5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.
6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.
- III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se; Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. 6. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare,

*autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogarit.*

III.2.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.7. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se: *2.. Në lidhje me pikën 2 për preparatin e tipit Cypermethrin 10 gr plus tetramethrin 2 gr dhe preparatit Cypermethrin 100 g/l ku sipas operatorit ekonomik citohet se autoriteti kontraktor ka bërë përcaktime të panevojshme që pengojnë konkurrencën e hapur sqarojmë se janë përmendur formulat e ilaçeve të cilat veprojnë që në larvë, pub dhe adult (i rritur). Nuk janë insekticide të vetëm një prodhuesi por ka shumë kompani që mund ti prodhojnë. Për sa i përket preparateve për luftimin e minjve sqarojmë se në ambiente të jashtme do të përdoren rodenticide, ndërsa në ambiente të brendshme do të përdoren kurthet multifunksionale për brejtës.*

III.2.8. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Konkretisht, në këtë rast, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, gjykojmë se përcaktime të tilla si preparati duhet të jete te tipit Cypermethrin 10 gr plus tetramethrin 2 janë tregues që nuk ndikojnë në performancën e produktit pra e rëndësishme është që produkti të arrijë qëllimin kryesor pra funksionimin e tij, për më tepër që autoriteti kontraktor në kthim-përgjigjen e tij nuk ka argumentuar teknikisht përse e kërkon këtë specifikim teknik, ndaj KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime të tilla në përcaktimin e specifikimeve teknike për sa kohë që performanca e produktit arrihet me secilën formë përbërësi dezinfektant (pra realizohet performancë pavarësisht specifikimit të përbërjes). Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me sa më sipër, duke aplikuar edhe termin “ekuivalent” me anë të së cilës operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë se disponojnë produktet me specifikimet teknike të kërkuara, në funksion të realizimit të synimit dhe kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron në lidhje me këto kriterë dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke përcaktuar termin ekuivalent në lidhje me dhe specifikimin teknik Cypermethrin 10 gr plus tetramethrin 2.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Gurali Stafaj” pf për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...].Së treti referuar shtojcës 10, në përshkrimin e shërbimeve sasia e pritshme nga Autoriteti Kontraktor, është shumë e madhe për realizimin e objektit të kësaj kontrate. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 10, “Shërbimet dhe Grafiku ”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon;

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi i Shërbimeve</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>Çmimi për njësi (Lekë pa TVSH)</i>	<i>Sasia e pritshme</i>
<i>1</i>	<i>Dezinfektim ambientesh</i>	<i>metra katrore (m2)</i>		<i>54,000</i>
<i>2</i>	<i>Dezinsektim ambientesh</i>	<i>metra katrore (m2)</i>		<i>18,000</i>
<i>3</i>	<i>Deratizim ambientesh</i>	<i>metra katrore (m2)</i>		<i>18,000</i>

*Afatet e ekzekutimit: Shërbimi do të kryhet për 12 (dymbëdhjetë) muaj ose me mbarimin e fondit limit të parashikuar.*

III.3.2 Në shtojcën 10, “Shërbimet dhe Grafiku ”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon;

*Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Në zbatim të legjislacionit veterinar dhe atij të ushqimit në fuqi është e detyrueshme të kryhet zbatimi i programeve paraprake të praktikave të mira të higjienës për zbatimin e procedurave të dezinfektimit të ambienteve të thertoreve/spitaleve/stabilimenteve përpunuese etj. si një instrument i vlefshëm për zbatimin e normave të higjienës në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor dhe në zbatimin e parimeve të sistemit HACCP.*

*Detyrat*

*Ofrimi i sigurisë higjeno – sanitare në ambientet ku do të kryhet shërbimi.*

*Shpërndarja:*

*Shërbimi do të kryhet për 12 (dymbëdhjetë) muaj ose me mbarimin e fondit limit të parashikuar.*

*Vendi i kryerjes së shërbimeve:*

*Klinikë Veterinare ndodhur në adresën ish-Filatura Tirana nr.2, të pambukta, ish-Kombinati i Tekstileve, Rruga e Kavajës, Tiranë, 1,000 m<sup>2</sup>*

*Zyrat e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit me adresë në rrugën “Abdi Toptani”, Tiranë, 500 m<sup>2</sup>*

III.3.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.6 Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se; Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-

*të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. 6. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.*

III.3.7 KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.8 Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se: *Në lidhje me pikën 3 ku citohet se sasia e pritshme është shumë e madhe për realizimin e objektit të kësaj kontrate, ju sqarojmë se sasi të (metrat katror) janë nevoja të parashikuara nga autoriteti kontraktor bazuar në sipërfaqet e ambienteve ku do të kryhet shërbimi DDD dhe në varësi të shpeshtësisë që do kryhet ky shërbim bazuar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme për këtë objekt prokurimi. Bazuar në sasi të pritshme është bërë dhe studimi i tregut dhe ka dalë fondi limit i pritshëm i marrëveshjes kuadër.*

III.3.9 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për mbarëvajtjen e shërbimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të autoritetit kontraktor në grafikun e shërbimit, specifikimet teknike dhe termave të referencës, në të cilën parashikohet të kryhet shërbimi i dezinfektimit për ambientet e parashikuara, sasia e pritshme për kryerjen e shërbimit është një kërkesë e domosdoshme dhe jokufizuese. Pra, referuar, termave të referencës që janë përcaktuar për këtë shërbim, Komisioni gjykon se sasia e pritshme për këtë shërbim e parashikuar nga autoriteti kontraktor është e nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, pasi dezinfektimi është një proces i cili do të kryhet për 12 muaj dhe qëllimi i shërbimit është dezinfektimi i ambienteve me sasinë e nevojshme,. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor referuar dokumenteve të tenderit, sasisë dhe grafikut të ekzekutimit, sipërfaqes për të cilën kërkohet dezinfektimi 1000m<sup>2</sup> për Klinikën Veterinare dhe 500 m<sup>2</sup> për zyrat e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, periudhës dhe kryerjes së shërbimit prej 12

muajsh, gjykon se sasia e pritshme për këtë shërbim e parashikuar nga autoriteti kontraktor është në përputhje dhe në proporcion me volumin e kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Gurali Stafaj” pf, për procedurën e prokurimit Nr. REF-96147-05-21-2021 me objekt “Dezinfektim, dezinfektim, deratizim ambientesh”, me fond limit 1,311,960 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
  2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Gurali Stafaj” pf,.
  5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**